



HISTORIK

Universitet i ri me traditë të vyer

Në Panteonin e vyer të kulturës shqiptare, me emrat më të shquar të pionerëve të arsimit Universiteti “Sevasti & Parashqevi Qiriazhi” është një gur themeli për të sotmen dhe të ardhmen e arsimit shqip. Historiku, tradita 100 vjeçare e dëshmon këtë më së miri
Tradita 100 vjeçare

1912 Hapet instituti “Kyrias” në një shtëpi në periferi të Tiranës

1922 U rihap instituti “Kyrias”

1925 U vendos guri i parë i themelit të shkollës

1926 Instituti “Kyrias” transferohet në Kamëz

2006 Rihapet Instituti, tashmë Universitet me emrin “Sevasti & Parashqevi Qiriazhi”

KRISTO DAKO 1876 - 1941

Një nga themeluesit, administrator dhe mësues i institutit femëror të vajzave “Kyrias” (Qiriazhi), sot Universiteti “S&P Qiriazhi”. Ai ishte bashkëshort i Sevasti Qiriazit. Studimet i kreu në Bukuresht për matematikë dhe më vonë në SHBA për filozofi.

Në vitin 1910 u caktua drejtor i Normales së Elbasanit. Radhitet ndër emrat më të shquar të patriotëve më aktivë në Evropë dhe në botë, si Faik Konica, Fan Noli, Luigj Gurakuqi, etj.

Njihet si publicist i shquar dhe ka botuar në revistat më prestigjioze të vendit si “Ylli i mëngjesit” “Albania”, “Dielli”, si dhe në shtypin e huaj “The Orient”, “The Times”, etj.

Ka botuar librat si “Cilët janë shqiptarët”, “Shqipëria, çelisi i Lindjes së Afërme”,

“Shënime nga Jeta dhe vepra e Nalt Madhenise se tij, Zogut I, Mbret i Shqiptarëve”, tekstin shkollor “Mësimet e para të Gjeometrisë elementare” etj. Anëtar dhe drejtues i disa shoqatave të rëndësishme të kohës si, “Shpresa”, “Dituria”, “Djalëria Shqiptare” dhe i klubeve “Bashkimi”, “Vëllazëria” dhe “Dielli i Shqipërisë” Pjesëmarrës në Konferencën e Paqes në Paris ku luftoi kundër copëtimit të Shqipërisë. U

takua dy herë me Presidentin Willson, në përprjekjen për të diskutuar për kufijtë e Shqipërisë.

Sistemi komunist e la për 50 vjet në harresë.

faqe 1

SEVASTI QIRIAZI 1871 – 1949

Ishte i vëllai Gjerasim Qiriazhi, që e shtyu të studionte në kolegjin me emër Robert College, në Konstandinopolje dhe të luante një rol aktiv në arsimimin e grave. Ajo që e para grua shqiptare që studioi në këtë institucion amerikan, të cilin e kreu në qershor 1891. Me t’u kthyer në Shqipëri bashkë me të vëllanë morën pjesë në ngritjen e shkollës së vashave në Korçë më 1891.



USPQ
UNIVERSITETI
SEVASTI
PARASHQEVI
QIRIAZI

USPQ NIPT: K6183001Q Adresa: Koder - Kamëz, Tirana, Albania
Tel. Sek. +355 47 200 844 www.uni-qiriazi.com

Pas Luftës së Parë Botërore kjo shkollë njihet ende me emrin e familjes Qiriazi. Ajo mori pjesë edhe në Kongresin e Manastirit, ku u mor kryesisht me përgatitjen e teksteve shkollore. Sevasti Qiriazi-Dako ka botuar një gramatikë për shkollat fillore (Manastir 1912) dhe ka redaktuar një radhë tekstesh historie. Me të shoqin, gazetarin dhe shkrimtarin Kristo Anastas Dako dhe me të motrën Parashqevi ajo vajti në Rumani e prej andej emigroi në Shtetet e Bashkuara, ku bashkëpunoi me të përdyjavshmen “Yll’ i mëngjesit”. Ajo ishte mësuese në shkollën e parë të vajzave dhe mësuese në Institutin “Kyrias”.

PARASHQEVI QIRIAZI 1887 – 1971

E njohur edhe me emrin Paraskevi Dh. Kyrias, studioi në Robert College në Konstantinopojë dhe u kthye në Shqipëri për të punuar si mësuese. Më 1909 ajo botoi një abetare për shkollat fillore. Më pas organizoi arsimin për të vegjël, shkolla mbrëmjeje në Shqipërinë jugore dhe ndihmoi për të vënë bazat e një sistemi bibliotekar. Më 1908 mori pjesë në Kongresin e Manastirit.

Ajo ndihmoi për themelimin e shoqatës “Yll’ i mëngjesit” më 1909 dhe në Shtetet e Bashkuara, botoi periodikun e ilustruar me të njëjtin emër, që doli në Boston nga 1917 deri më 1920.

Parashqevi Qiriazi mori pjesë edhe në Konferencën e Paqes në Paris më 1919 si përfaqësuese e bashkësisë shqiptaro-amerikane. Ishte një nga themelueset dhe mesueset e Institutit “Kyrias”. Në vitin 1910 ishte drejtore e shkollës së vashave në Korçë. Shkroi

hymnin e alfabetit shqip “Sot është dita shqipëtarë të përpiqemi...”. Më 1915 ajo u bë drejtuese e shoqatës “Miqte e Shqipërisë së lirë” në Amerikë. Gjatë vitit 1926 punoi si drejtore e Institutit të vashave “Kyrias”.